

Curriculum Vitae

Të dhënat personale

Emri/Mbiemri **Olsian Çela**
Datëlindja 03.07.1977
Vendlindja Fier, Shqipëri
Shtetësia Shqiptare
Vendbanimi Tiranë, Shqipëri
E-mail olsian.cela@pp.gov.al

Eksperiencia e punës

6.1.2004 – 2019 Prokuror në Prokurorinë për Krime të Rënda
20.9.2018 - 21.1.2019 Prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat (caktim i përkohshëm)
25.6.2008 - 20.12.2012 Drejtues i Prokurorisë për Krime të Rënda
1.10.2001 - 6.1.2004 Prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë

Angazhimet profesionale

2015-2016 Ekspert i jashtëm në grupet e ekspertizës së Reformës në Drejtësi
2010-2014 Anëtar i Bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës
2012-2013 Pikë kontakti e Eurojust për Prokurorinë Shqiptare

- | | |
|-----------|---|
| 2011-2012 | Përfaqësues i Prokurorisë Shqiptare në Këshillin Konsultativ të Prokurorëve Europeanë |
| 2008-2012 | Anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë |
| 2008-2012 | Këshilltar rezident i projektit "Mbështetje për Prokurorinë Shqiptare në kryerjen e inspektimit dhe vlerësimit të prokurorëve".
Partnerët: Prokuroria Shqiptare, Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm në Spanjë, Këshilli i Lartë i Magjistraturës Itali" |
| 2008-2019 | Ekspert i Programit të Trajnimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës |
| 2007 | Kontribues në hartimin e manualit trajnues "Hetimet Financiare dhe konfiskimi i produkteve të krimit" (Projekti Carpo i Këshillit të Evropës, Programi Rajonal Cards) |

Trajnime profesionale

- | | |
|---|--|
| 6.6.2002-20.6.2002
Kroaci | Shkolla e të drejtave të njeriut për vendimarrësit e ardhshëm |
| 16.6.2003-27.6.2003
Tiranë | Kurs trajnimi për përzgjedhjen si anëtar i Grupit të Punës së Krimit të Organizuar, organizuar nga Pameca dhe Departamenti i Drejtësisë së Sh.B.A. |
| 20.2.2006-23.2.2006
Francë | Kursi i trajnimit të trajnerëve për " Hetimet financiare dhe konfiskimin e produkteve të krimit" organizuar nga Këshilli i Evropës, projekti Carpo |
| 5.6.2006-24.5.2006
Shtetet e Bashkuara të Amerikës | Pjesëmarrës në Programin e lidërshipt të vizitorit ndërkombëtar nga Departamenti i Shtetit në Sh.B.A. |
| 14.1.2008-4.4.2008
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe | Programi "Chevening Fellowship", në Akademinë Ndërkombëtare të Bramshill "Përballja me krimin e organizuar ndërkombëtar", |
| 2003-2019 | Trajnimet e Programit të Trajnimit Vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera të organizmave ndërkombëtarë |

Angazhime akademike

- | | |
|-----------|---|
| 2009-2010 | Pedagog i jashtëm i së drejtës penale "Fakulteti i Drejtësisë Justiniani I", Tiranë |
| 2010-2011 | Pedagog i jashtëm i së drejtës penale "Universiteti Aleksandër Moisiu", Durrës |

Gjuhët e huaja**Të kuptuarit****Të folurit****Të shkruarit***Niveli evropian (*)***Anglisht (diplomë)****Italisht (diplomë)****Frëngjisht****Gjermanisht**

Dëgjimi

Leximi

Ndërveprimi në të folur

Produktiviteti në të folur

C2	Shkëlqyeshëm	C2	Shkëlqyeshëm	C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë	C2	Shkëlqyeshëm
C2	Shkëlqyeshëm	C2	Shkëlqyeshëm	C1	Shumë mirë	C1	Shumë mirë	C2	Shkëlqyeshëm
C2	Shkëlqyeshëm	C2	Shkëlqyeshëm	C1	Shumë Mirë	C1	Shumë Mirë	C1	Shumë mirë
B2	Mirë	C1	Shumë mirë	B2	Mirë	B2	Mirë	B2	Shumë mirë

Përshkrim i eksperiencës në punë.

Karrierën si prokuror e kam nisur në Prokurorinë e Tiranës ku kam kryer stazhin profesional të vitit të tretë dhe u emërova më pas. Në vitin 2004, u emërova prokuror në Prokurorinë për Krime të Rënda, e cila përfaqëson një risi për kohën dhe u kthye në model për rajonin. Gjatë kësaj periudhe si prokuror kam hetuar dhe ushtruar ndjekjen penale për çështje mjaft të vështira dhe komplekse, të cilat kanë përfunduar me sukses. Në qershorin e vitit 2008 u emërova drejtues i kësaj prokurorie. Përgjatë viteve që e drejtova këtë prokurori, u hetuan dhe përfundoi me sukses gjykimi për disa nga grupet më të rrezikshme kriminale në vend. Rezultatet e punës së kësaj prokurorie kanë përbërë treguesit më pozitivë të drejtësisë shqiptare në procesin e integritetit dhe ajo ka gëzuar besimin më të lartë të publikut. Dua të theksoj përvojën e akumuluar gjatë drejtimit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, si prokuroria më e rëndësishme në vend, edhe në drejtim të bashkëpunimit me autoritetet e huaja, i cili kanë qenë në themel të suksesit të saj. Ajo ia doli të kthehej në një partner të besueshëm dhe kompetent për homologët e vendeve të tjera. Pas largimit nga pozicioni i drejtuesit në dhjetor 2012, vazhdova detyrën si prokuror në këtë prokurori, ku sërish kam hetuar dhe ushtruar ndjekjen penale për çështje të rëndësishme të krimit të organizuar apo krime të tjera të rënda. Gjatë karrierës sime kam qenë anëtar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, anëtar i Bordit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, funksione këto të rëndësishme për administrimin e sistemit të drejtësisë. Përfaqësimi i prokurorisë në Këshillin Konsultativ të Prokurorëve Evropianë i dha një dimension të ri formimit tim profesional, në kuptim të përqaftimit të ideve më progresive për funksionimin e sistemit të prokurorisë në Evropë. Një eksperiencë e shkëlqyer ka qenë edhe kontributi si këshilltar rezident i projektit për inspektimin dhe vlerësimin e prokurorëve, që hodhi bazat e sistemit të sotëm të vlerësimit të prokurorëve. Përtej sa më sipër, përvoja 11 vjeçare si ekspert i programit të trajnimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, më ka ndihmuar në krijimin e një perceptimi të drejtë për nivelin profesional të magjistratëve në sistemin e drejtësisë, problemet e funksionimit dhe nevojat e sistemit.